



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 21 prill 2011
Nr. ref.: RK97/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 10/10

Parashtruesi

Zvezdana Dimitrijević

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit, të Dhomës së Posaçme të Gjykatës
Supreme të Kosovës, SCEL-09-0001 të 8 janarit 2010**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është znj. Zvezdana Dimitrijević, nga Graçanica.

Objekti i çështjes

2. Parashtruesja e kërkesës pohon se me Vendimin SCEL-09-0001 C-631, të 8 janarit 2010, të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, është shkelur neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Procedura në Gjykatë

3. Parashtruesja e kërkesës parashtrroi një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese më 29 janar 2010.
4. Më 19 gusht 2010, Gjykata Kushtetuese e njoftoi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për parashtrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo nëse kishte ndonjë koment që do të ishte me interes për t'u shqyrtuar nga Gjykata në lidhje me këtë çështje.
5. Më 25 gusht 2010, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës u përgjigj duke thënë se 31 dëgjime publike ishin mbajtur, dhe se në njërin prej tyre, përkatësisht më 21 prill 2010, znj. Zvezdana Dimitrijević ishte personalisht e pranishme, kishte marrë pjesë dhe ishte dëgjuar.
6. Për më tepër, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës informoi se ende nuk ishte marrë asnjë vendim për rastin SCEL-09-0001 dhe se procedura ende është në zhvillim e sipër.
7. Më 21 janar 2011, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Almiro Rodrigues, Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Ivan Čukalović dhe Gjyljeta Mushkolaj, anëtarë, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Më 10 janar 2007, parashtruesja e kërkesës parashtrroi një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit në Prishtinë, të 9 majit 2003, në të cilën pohonte se ajo do të duhej të ishte në listën e punëtorëve legjitimë për 20 përqindëshin e të ardhurave nga privatizimi i ndërmarrjes shoqërore (në tekstin e mëtejshëm: NSH "Ramiz Sadiku").
9. Rrjedhimisht, më 7 shtator 2006 ajo paraqiti një shkresë urgjente në Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit për të njëjtën çështje.
10. Më 4 mars 2009, AKP-ja botoi në të përditshmen "Koha ditore" listën e punëtorëve legjitimë për 20 përqindëshin e të ardhurave nga privatizimi i NSH "Ramiz Sadiku". Emri i parashtrueses nuk është në këtë listë.
11. Parashtruesja e kërkesës ushtroi ankesë kundër AKP-së në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës më 23 mars 2009.
12. Më 5 maj 2009, AKP-ja i dërgoi përgjigje Dhomës së Posaçme në lidhje me ankesën e parashtrueses në të cilën thuhet se në kohën e privatizimit, pra më 27 qershor 2006, parashtruesja e kërkesës nuk ishte e regjistruar si e punësuar e NSH "Ramiz Sadiku" për faktin se parashtruesja e kërkesës kishte punuar në këtë NSH prej vitit 1972 deri në vitin 1999, dhe se rastin e saj e ka paraqitur brenda afatit të fundit të paraparë nga AKP-ja (31 gusht 2007).

13. Dhoma e Posaçme e njoftoi Gjykatën se, në lidhje me këtë rast, një seancë dëgjimore është mbajtur më 21 prill 2010 dhe se rasti i parashtrueses së kërkesës është ende në procedurë e sipër.

Pretendimet e parashtruesit

14. Parashtruesja e kërkesës pohon që emri i saj duhet të përfshihet në listën e punëtorëve legjitimë për 20 përqindëshin e të ardhurave nga privatizimi i NSH “Ramiz Sadiku”, në përputhje me Transformimin e të Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme Shoqërore. Neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 thotë si vijon:
- i. *“Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e të ardhurave të ndërmarrjes më shumë se tri (3) vite. Kjo kërkesë nuk i ndalon punëtorët, të cilët pohojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, sikur mos të ishin diskriminuar sa i përket paraqitjes së ankesave Dhomës së Veçantë, në pajtim me paragrafin 10.6”.*
15. Parashtruesja po ashtu pohon se ka qenë në listën e pagave për më shumë se 17 vjet, beson se i janë shkelur të drejtat e saj dhe se në raport me numrin e viteve dhe muajve që ka punuar në NSH “Ramiz Sadiku”, ajo ka të drejtë për kompensim të duhur në para.

Vlerësimi i pranueshmërisë të kërkesës

16. Për të gjykuar për kërkesën e parashtrueses, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesja i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në ligj dhe në Rregullore të punës.
17. Këto kriterë janë, para së gjithash, që parashtruesi mund ta ngrejë çështjen para Gjykatës në mënyrë ligjore (neni 113.1 i Kushtetutës) dhe pasi t'i ketë shterur të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj (neni 113.7 i Kushtetutës).
18. Sa i përket rastit në fjalë, në bazë të informacioneve të pranuar nga Dhoma e Posaçme më 15 shtator 2010, ky rast është ende në procedurë e sipër në Dhomën e Posaçme dhe, si rrjedhim, kërkesa është e parakohshme pasi parashtruesja ende nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj.
19. Prandaj, Gjykata konkludon që kërkesa është e papranueshme, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës.

PËR KËTË ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, Nenit 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, si dhe Rregullit 56 (2) të Rregullores së Punës, njëzëri

VENDOS

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues



Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani